



**Gjetja e  
fondeve në  
shkolla**

# Gjetja e fondeve në shkolla



## Hyrje

Gjetja e fondeve mund të përcaktohet si mbledhje e fondeve/të mirave/shërbimeve për realizimin e ideve dhe aktiviteteve tona, të cilat kontribuojnë në përmbushjen e tyre. Jo gjithçka është rreth parave dhe mënyrës se si sigurohen ato, por më e rëndësishme është të punohet rreth krijimit të bashkëpunimeve afatgjata me donatorë potencialë, pasi në këtë mënyrë ne sigurojmë burime të qëndrueshme për të tashmen dhe të ardhmen. Ditët e sotme, gjetja e fondeve është shndërruar në shkencë me metodologji gjithëpërfshirëse dhe udhërrëfyese konkretë, që mund të na mësojnë se si të bëhemi të suksesshëm në gjetjen e fondeve. Por si duhet të veproni, nëse ju jeni mësimsdhënës/e në shkollë, kur ju duhet të bëni projekte të bazuara në shkollë, pa buxhet shtesë për aktivitetet jashtë-kurrikulare dhe, njëkohësisht, jeni të motivuar për të pasur sukses? Ky dokument apo mjet informues mund t'ju mbështesë në misionin tuaj.



## Gjetja e fondeve në shkollë

Buxhetet e vogla dhe investimet e pakta të qeverisë mund ta vështirësojnë jetën nëpër shkollë dhe mund t'i shtyjnë ato që të kërkojnë mundësi të tjera për gjetje fondesh. Për njerëzit që përballen me gjetjen e fondeve për të parën herë, si dhe kërkuesit e fondeve që nisin projekte të reja në sezona të caktuara, gjetja e fondeve për shkollë mund të jetë detyrë sfiduese. Por jo gjithnjë mund të jetë ashtu, pasi gjithnjë ka një rrugëzgjdhje. Me një qasje të organizuar, kushdo mund t'i transformojë përpjekjet në fushatë të suksesshme për gjetjen e fondeve.

Gjetja e fondeve mund të jetë mënyrë e mirë për t'u lidhur me komunitetin e nxënësve/eve dhe mësimitdhënësve/eve në shkollë. Gjithashtu, mund të jetë mundësi e mirë që ju të përfshihen drejtpërsëdrejti në mbledhjen e të hollave për shkollën dhe për programet e saj, si dhe të ofroni mbështetje për shkollën.

*Nuk është e gjitha për paratë dhe mbledhjen e tyre, më shumë duhet të jetë për krijimin e partneriteteve afatgjate me donatorë potencialë...*

## Hapat për gjetjen e fondeve

Hapat në vijim mund ta bëjnë më të lehtë procesin e të mësuarit përmes veprimit, gjë që është një prej mënyrave më efektive se si t'i qasemi temës dhe se si të fillojmë të realizojmë aktivitete për gjetjen e fondeve.

### 1. Krijimi i ekipit për gjetjen e fondeve në shkollë

2. Ekipi i gjetjes së fondeve duhet të përbëhet prej Bordit dhe Drejtorit/es së shkollës, mësimitdhënësve/eve, prindërve dhe nxënësve/eve. Nuk është e domosdoshme që ekipi të jetë i madh, megjithatë është e rëndësishme që të gjitha palët e interesuara të përfaqësohen. Inicuesit/et e ekipit për gjetjen e fondeve mund t'i prezantojnë idetë e Bordit dhe Drejtorit/es në mbledhjen e mësimitdhënësve/eve, në këshillin e prindërve dhe te këshillat e nxënësve/eve, nëse ato ekzistojnë, dhe pastaj njerëzit mund të votojnë për përfaqësuesin/en e ekipit të tyre apo thjesht të zgjedhin një përfaqësues/e. Përfaqësuesit/et e përzgjedhur/a duhet të jenë të motivuar/a që të ballafaqohen me këtë temë; pra është shumë e rëndësishme që ata/ato të kenë vullnet të marrin pjesë në përpjekjet e ekipit në baza vullnetare. Kur të krijohet ekipi, ju mund t'i publikoni emrat e anëtarëve/eve të ekipit në tabelën informuese në shkollë, si dhe kontaktet e tyre, me qëllim që nxënësit/et, prindërit apo mësimitdhënësit/et të mund t'i kontaktojnë kurdoherë, pasi një gjë e tillë është e nevojshme.

*Ekipi nuk duhet domosdoshmërisht të jetë i madh por është e rëndësishme që të gjitha palët të përfaqësohen...*

### 3. Zhvillimi i një strategjie për ngritjen e fondeve

Ekipi i krijuar duhet të zhvillojë një Strategji të Shkollës për Gjetje Fondesh. Ky nuk është proces i lehtë dhe mund të bëhet në forma të ndryshme. Nëse ekipi ka nevojë për mbështetje, mund të përfaqësohet nga një ekspert/e (ndoshta përmes ndonjë prindi, kompanie të ndonjë prindi apo përmes ndonjë OJQ-je) që ka vullnet të kontribuojë vullnetarisht (pa kompensim në pagë), duke ndihmuar në zhvillimin e strategjisë apo duke i trajnuar anëtarët/et e ekipit se si duhet zhvilluar diçka e tillë. Një mundësi tjetër është që shkolla të sigurojë të ardhura për të punësuar një ekspert/e. Nëse asnjëra prej këtyre mundësive nuk mund të realizohet, atëherë këto pika dhe pyetje mund ta ndihmojnë ekipin:

**Përcaktoni problemin**



**Përcaktoni synimin**



**Përcaktoni aktivitetet**



**Përcaktoni mbështetësit**



**Përcaktoni tabelën**



**Përcaktoni shpenzimet**



**Përcaktoni procedurat**



- › Përcaktoni problemin – Me çfarë problemesh përballet shkolla. Mos u përqendroni te mungesa e parave, por identifikoni veprimet që do të çonin te zgjidhja e problemeve, të cilat më pas mund të zgjidhen përmes mbledhjes së parave dhe investimit të parave në zgjidhjen e problemeve.
- › Përcaktoni synimin – Do të ishte mirë, nëse do mund të përgatitni një vizion për shkollën. Si do të dukej shkolla juaj në të ardhmen, pas 10 viteve? A do njihet shkolla juaj si institucion me ambient shumë të mirë për nxënësit/et dhe mësimdhënësit/et? Deri në atë periudhë, a do shquhet shkolla juaj, për sa i përket realizimit të Programit Y (edukimi për shkathtësi jetësore) në komunitet, qytet, rajon?
- › Përcaktoni aktivitetet – Renditini të gjitha aktivitetet që duhet ndërmarrë, me qëllim që problemet tuaja të zgjidhen dhe vizioni juaj të përmbushet. Mos u frikësoni, lista mund të jetë e gjatë; qëllimi është që të renditni gjithçka që ju duket e nevojshme, gjithçka që duhet bërë (që nga takimet e rregullta të ekipit për gjetje fondesh, logjistika rreth aktiviteteve për gjetje fondesh e deri te festa për marrjen e fondeve). Zhvilloni një Plan Veprimi të detajuar, me qëllim që t’ju ndihmojë t’i përmbushni të gjitha kërkesat tuaja me kohë.
- › Përcaktoni mbështetësit/et – Bashkë me detyrat e radhitura në planin e veprimit, ju duhet të identifikoni njerëzit që do t’ju ndihmojnë në realizimin e këtyre detyrave (siç janë nxënësit/et, mësimdhënësit/et, prindërit, por edhe udhëheqësit/et e komunitetit, ndërmarrësit/et lokal/e, mediet etj.) Në këtë fushatë krijoni një listë të kontakteve, e cila përmban të gjithë emrat, adresat elektronike, numrat e telefonit etj., pasi këto të dhëna do t’ju nevojiten më vonë.
- › Përcaktoni tabelën kohore, rolet dhe përgjegjësitë – në këtë fushë përcaktoni datën e fillimit, kohëzgjatjen e veprimit dhe afatin e përfundimit. Më pas, përcaktoni se kush do të jetë përgjegjës/e për secilin aktivitet apo për secilin segment të aktivitetit.
- › Përcaktoni shpenzimet – Edhe pse i gjithë ky proces realizohet për gjetje fondesh, është e domosdoshme që të sigurohet një shumë e vogël e parave për të realizuar këto aktivitete operacionale. Gjithashtu, ky është moment i rëndësishëm, pasi ju vendosni se sa pará do ju duhen për realizimin e aktiviteteve dhe se cilët do të jenë donatorët potencialë.

Më poshtë mund të gjeni një shembull të strategjisë për gjetje fondesh për një problem. Ju mund ta krijoni këtë tabelë për secilin prej problemeve, në të cilët përqendroheni.

	AKTIVITETI	TABELA KOHORE	MBËSHTETËSIT/ET	SHPENZIMET	PËRGJEGJËSITË
1					
2					

- › Përcaktoni procedurat për menaxhim të fondeve – duhet të jeni shumë të saktë në krijimin e protokollit dhe të procedurave për menaxhimin e fondeve të gjetura. Sigurohuni të respektoni ligjet kombëtare, por edhe udhëzimet e shkollës për shpenzime, kontabilitet, prokurim, si dhe procedurat e tjera ligjore.

PËRCAKTONI  
PROBLEMINPËRCAKTONI  
SYNIMINPËRCAKTONI  
AKTIVITETETPËRCAKTONI  
MBËSHTETËSIT/ETPËRCAKTONI  
TABELËN KOHOREPËRCAKTONI  
SHPENZIMETPËRCAKTONI  
PROCEDURAT

#### 4. Realizoni hulumtim

Mbledhja e të dhënave është hap shumë i rëndësishëm për zhvillimin e strategjisë suaj, megjithatë kjo praktikë duhet të bëhet pjesë përbërëse e gjithë procesit (mblidhni vazhdimisht të dhëna para, gjatë dhe pas iniciativës për gjetje të fondeve). Mbledhja e të dhënave do t'ju ofrojë larmi të të dhënave të nevojshme: që nga identifikimi se çfarë ju nevojitet dhe se si mund të jenë idetë për aktivitetet që kanë shkuar mirë dhe për ato që nuk kanë shkuar mirë. Mund të mblidhni të dhëna në forma të ndryshme: duke organizuar fokus grupe (GF), intervista individuale me nxënës, prindër dhe mësimdhënës/e ose duke krijuar një tryezë informative që mund të shërbejë përgjatë pushimeve të shkollës për nxënësit/et, të cilët/at mund të marrin informacione shitesë apo edhe t'i ndajnë rekomandimet dhe idetë e tyre. Gjithashtu, një pjesë e hulumtimit mund të realizohet online, ku mund të mësohet se si ballafaqohen shkollat e tjera me probleme të ngjashme. Në momentin që mblidhet i gjithë informacioni, ju mund ta analizoni atë dhe të filloni me procesin e planifikimit.

*Mbledhja e të dhënave është hap shumë i rëndësishëm për zhvillimin e strategjisë tuaj...*

#### 5. Konsultohuni me komunitetin tuaj – mos kini ndrojtje të pyesni

Mos harroni se shkolla juaj i përket komunitetit dhe se ka shumë njerëz që jetojnë në komunitetin tuaj e që mund t'ju ndihmojnë e t'ju mbështesin në rrugëtimin tuaj. Dilni dhe takohuni me zyrtarë/e të komunës, me median lokale, klube sportive, shoqata profesionale, organizata të artit dhe kulturës, si dhe këdo që ju e shikoni si palë interesi e që mund të kontribuojë në proces. Ofrojini atyre mundësinë dhe siguron hapësirën e nevojshme që ata të përfshihen e të marrin pjesë në mënyrë aktive. Ka shumë mënyra se si njerëzit mund t'ju ndihmojnë, dhe mbështetja financiare është vetëm njëra prej shumë mënyrave.

#### 6. Organizoni dhe realizoni aktivitete

Kur të ketë përfunduar faza e planifikimit dhe kur t'i keni përcaktuar qartazi hapat, atëherë është koha të VEPRONI. Filloni me aktivitetin e parë dhe ndiqeni me kujdes procesin. Mbani mend që duhet të jeni të epshëm dhe të gatshëm të adaptoheni me sfidat që mund të paraqiten – që edhe do të paraqiten – pasi sfidat gjithnjë janë të pranishme, por e rëndësishme është që ju të jeni të përqendruar në atë që dëshironi të arrini.

*Kur të përfundojë faza e planifikimit dhe hapat tjerë janë të definuar qartazi, është koha për të VEPRUAR...*

#### 7. Mësoni prej përvojës dhe përmirësohuni

Kur të ketë përfunduar procesi dhe kur t'i keni gati të dhënat për monitorim, analizoni ato dhe mësoni prej tyre. Nëse keni paraqitur një listë të qartë treguesve/indikatoreve për matjen e përparimit tuaj, përdorini ato që të vlerësoni nivelin e arritjeve. Organizoni një takim të vlerësimit për ekipin e gjetjeve të fondeve dhe diskutoni mbi rezultatet e suksesin, si dhe sfidat; e kështu mësoni prej tyre. Këto janë mësimë shumë të rëndësishme për veprimet tuaja në të ardhmen.

# Stilet e gjetjes së fondeve

## 1. Gjetja e fondeve në shkollë

Gjetja e fondeve në shkollë është praktika e sigurimit të parave për të mbështetur programet e pasurimit edukativ prej shkollës apo grupeve shkollore. Ka shumë mënyra se si të sigurohen fonde në shkollë, dhe ky udhërrëfyes do të prezantojë disa prej tyre. Duhet të jeni shumë të qartë rreth asaj se përse po organizohet veprimtaria, dhe se si do të shpenzohen fondet e mbledhura. Të qenit transparent në këtë mënyrë, do t'i bëjë njerëzit që t'ju besojnë dhe të jenë plotësisht të sigurt se për çfarë kauze ata po kontribuojnë. Në disa veprimtari, ju mund të ofroni certifikata të vlerësimit, simbole falënderimi etj., dhe në këtë mënyrë shfaqni mirënjohjen tuaj ndaj njerëzve që ju kanë mbështetur.

*Duhet gjithmonë të jeni shumë të qartë për arsyen pse po organizohet ngjarja...*

**Riciklimi** – Përgatitja apo sigurimi i kutive për riciklimin e letrave dhe plastikës, të cilat duhet të vendosen nëpër të gjithë shkollën, dhe që mund të akumulojnë shumë fonde për periudhë afatgjatë, sepse më pas, përmes këtyre kutive shkolla mund të marrë fonde prej shërbimeve publike komunale. Duhet të lidheni me shërbimet komunale, të merrni informacion dhe të formoni bashkëpunim. Mbledhja e plastikës dhe e letrave duhet të bëhet prej mësimdhënësve/eve dhe nxënësve/eve, dhe para gjithë kësaj ju mund të organizoni një aktivitet promovues në shkollë, i cili do të paralajmërojë fillimin e këtij procesi. Pasi t'i keni siguruar kutitë, nxënësit/et dhe mësimdhënësit/et mund të fillojnë riciklimin. Në fakt, ju mund të bëni një garë mes klasave, se cila klasë po mbledh më shumë material, ndërsa në fund të vitit shkollor mund të organizoni një festë të vogël për aktivitetin, ku mund të shpallni edhe klasën fituese, si dhe të mblidhni fondet e krijuara nga ky aktivitet. Kjo veprimtari mund të vazhdojë, si dhe të shndërrohet në aktivitet të vazhdueshëm për mbledhje fondesh.

**Panairi i shkollës** – mund të organizohet një herë në vit. Me këtë rast, nxënësit/et mund të krijojnë disa punime të tyre artistike ose t'i dhurojnë ato për t'i shitur në panairin e shkollës. Ky është gjithashtu një rast ku mund të shitni biskota dhe limonadë, si dhe aktiviteti më i mirë ku mund të përfshihen edhe prindërit e mësimdhënësit/et. Gjithashtu, kjo ngjarje mund të përdoret përgjatë prezantimit të iniciativave të shkollës te donatorët dhe te palët e interesit nga komuniteti (mund të organizohet në ditën e shkollës).

**Garat sportive** – aktivitet ideal organizuar në vende të hapura, ku ekipet mund të paguajnë një shumë simbolike për të marrë pjesë. Mund të përfshijë aktivitete dhe ekipe të ndryshme sportive: ekipet e prindërve, ekipet e mësimdhënësve/eve, ekipet e nxënësve/eve, si dhe ekipet e udhëheqësve/eve të komunitetit. Në këtë ngjarje mund të ftoni sportistë/e të famshëm/e, ku të tërhiqni edhe vëmendjen e komunitetit.

**Dita EKO** – Krijoni një aktivitet, ku të gjithë mësimitdhënësitet dhe nxënësitet të vishen me rroba të gjelbra, dhe organizoni një pastrim e mbjellje lulesh apo pemësh nëpër shkollë. Mund të merrni lule falas, fara dhe fidanë nga bizneset pranë shkollës. Natyrisht, pjesëmarrja është një “shumë e gjelbër”.

**Dreka** – Mund të ftoni disa kuzhinierë/e nga restorantet lokale që të gatujnë drekën ose të përgatisin ushqime të lehta për nxënësitet dhe mësimitdhënësitet në shkollë, të cilët/at mund ta blejnë drekën prej tyre. Prej fondeve të mbledhura ju mund të paguani për mjetet që ju nevojiten për këtë aktivitet, por edhe të rrisni fondet shtesë.

**Festë shkollore** – Duke e bërë hyrjen në festë me pagesë për nxënësitet, të cilët mund të argëtohen duke vallëzuar dhe të bisedojnë më njëri/a-tjetrin/ën. Kjo është një mundësi e mrekullueshme që të promovoni stile të shëndosha të jetesës dhe të promovoni pije jo-alkoolike, të cilat mund t’i merrni nga mbështetësit e lokaleve përreth shkollës.

**Ditë lojërash** – Kërkoni nga nxënësitet/et që të sjellin lodra dhe lojëra të ndryshme që të luani ditën e fundit të semestrit shkollor dhe të kërkoni donacione.

**Loja me shfaqje** – Organizoni versionin tuaj të “Kush do të bëhet milioner?” ose “Lidhjen më të dobët”. Por mund të adaptoni edhe lojëra të ndryshme për një audiencë më të madhe dhe të përfitoni donacion të çmimeve.


**Karaoke** – Organizoni X Faktorin tuaj (këtu mund të organizoni edhe ndonjë program të famshëm në mjediset e lagjes që lidhet me këngën).

**Gjuajtja e shigjetës** – Kërkoni nga nxënësitet/et që të paguajnë shuma të vogla, me qëllim që të kenë mundësi të hedhin shigjeta me sapun drejt mësimitdhënësve/eve të tyre. Kjo realizohet më mirë përgjatë ditëve me diell.

**Gara e talenteve** – Organizoni një garë të talenteve, ku nxënësitet/et mund të shfaqin talentet e tyre. Mund ta bëni këtë sipas modelit të ndonjë programi televiziv, duke paraqitur jurinë, e cila do të zgjedhë fituesitet/et.

**Kërkimi i thesarit** – Përgatisni një kërkim thesari, ndajini nxënësitet/et në grupe apo ekipe dhe më pas puna detektive mund të fillojë. Kërkoni nga ndonjë biznes lokal që të ofrojë çmimin për fituesitet/et, si donacion, dhe vendosni një shumë të vogël si pagesë për ata/ato që duan të bëhen pjesë e lojës.

**Dita Botërore e Kulturës** – Lajmërojini nxënësitet/et që të vishen enkas për këtë ditë dhe kërkoni nga secila klasë që nxënësitet, nëpërmjet veshjes, të imitojnë ngjyrat e flamujve apo të përfaqësojnë shtete të ndryshme.





**Loja e bamirësisë së mësimdhënësve/eve** – Inkurajojini nxënësit/et që të jenë të entuziazmuar për të ndjekur një lojë të veçantë sportive me ekipe të përbëra nga mësimdhënësit/et e tyre. Shitini biletat për të parë lojën. Kjo mund të jetë lojë serioze apo edhe diçka komike.

**Koncert për bamirësi nga mësimdhënësit/et** – Mblidhni mësimdhënësit/et në një koncert muzikor për nxënësit/et. Shitini biletat për të parë mësimdhënësit/et, duke performuar këngë – në grup të madh apo në grupe të vogla. Mësimdhënësit/et mund të bëhen kreativë/e dhe të ftojnë performues të mirënjohur ose sponsorë nga komuniteti që të bashkohen në koncert.

**Stërvitje** – Kërkoni nga trajnerët/et e shkollave të mesme të realizojnë stërvitje për sporte, më pas i prezantoni këto mundësi te komuniteti.

Darkë apo paradreke për gjetje fondesh – ku mund të ftoni institucionet apo bizneset lokale që të marrin pjesë, me qëllim që ju t’ua prezantoni atyre idetë tuaja (dyqanet e lagjes, baret apo restorantet mund të dhurojnë pije dhe ushqim). Ky është vendi ku ju mund të kërkoni nga pjesëmarrësit/et mbështetje për idetë tuaja.

## 2. Gjetje fondesh në komunitet

Ka shumë burime materiale dhe jo-materiale në komunitetin tuaj, të cilat mund të përdoren si mbështetje për programet dhe aktivitetet e shkollës. Së pari, duhet të identifikoni shërbimet, dyqanet, restorantet, kompanitë, bizneset ekzistuese etj., dhe të mësoni objektivat e tyre, me qëllim që të identifikoni se si lidhet puna e tyre me veprimtarinë tuaj, si dhe të gjeni qëllime e interesa të përbashkëta. Së dyti, ju duhet të takoheni dhe të diskutoni me ta për çfarë juve ju nevojitet. Duhet të jeni shumë të qartë e të saktë në kërkesat tuaja, si dhe për mënyrën se si ata mund t’ju ndihmojnë (përmes fondeve, kohës, shërbimeve, mjeteve). Përpiquni t’u shpjegoni atyre që angazhimi dhe mbështetja e tyre do të bëhet publike e, kështu, kjo mund t’u shërbejë atyre edhe si reklamim apo promovim (përmes komunikatave për shtyp, mediave online, video-klipeve).

Një fillim i mbarë mund të jetë kryerja e një veprimtarie të mirë për komunitetin tuaj. Ka shumë veprime të tilla që mund të realizohen, duke përfshirë këtu pastrimin e parkut të mjedisit ku ndodhni, mbjellja e luleve, dekorimi i stolave apo rinovimi i disa hapësirave të vjetra publike, ose mund të organizoni një festival muzikor që mbledh të gjithë/a përfaqësuesit/et e komunitetit, të cilët vizitojnë shkollën tuaj dhe njihen me planet tuaja në vazhdim. Mbani mend që ta trajtoni këtë partneritet lokal si një përkushtim afatgjatë, e jo si përkushtim që ndodh vetëm një herë. Në këtë mënyrë njerëzit lidhen me shkollën tuaj, motivohen dhe inspirohen të kontribuojnë dhe t’ju mbështesin për një periudhë më të gjatë kohore.

*Duhet të jeni shumë të qartë dhe prezisë rreth asaj që doni dhe mënyrave si mendoni se ata mund t’ju ndihmojnë.*

### 3. Gjetja e fondeve brenda dhe jashtë shtetit

Gjetja e fondeve mund të bëhet me të gjithë donatorët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, por edhe shtetet e Ballkanit mund të marrin fonde nga BE-ja, para se të integrohen në të. Donatorët vendorë dhe ndërkombëtarë zakonisht bëjnë thirrje të hapura për tema specifike që do donin t'i mbështesnin, si dhe afatin kohor se deri kur duhet ta dorëzoni propozimin tuaj. Në propozimin tuaj ju duhet të jeni të qartë e ta shpjegoni problemin që doni të zgjidhni, dhe se çfarë do të ndryshojë pas realizimit të projektit tuaj. Ky proces nganjëherë është sfidues, pasi ju duhet që fillimisht të shikoni nëse ju si shkollë mund të aplikoni në një kërkesë; ndërsa më pas duhet t'i rishikoni të gjitha çështjet ligjore rreth aplikacionit. Pastaj fillon procesi i zhvillimit të idesë, që zakonisht duhet të përshkruhet në letër, si dhe duhet të jetë i shpjeguar mirë në projektin e propozuar, të jetë i arsyetuar logjikisht, të saktësohet buxheti dhe format e dokumentet e planit të veprimit. Këto janë burime të kufizuara me kohë dhe me procedura të qarta, se si duhet të shpenzohet gjithçka, e që më pas çdo gjë duhet të kryhet ashtu siç është e shkruar. Mbase ka ndonjë ekspert/e lokal/e ose prind që ka njohuri se si të zhvillohet një propozim projekti dhe dokumentet e tjera. Identifikojini ata/ato dhe kërkonit prej tyre që t'ju ndihmojnë. Ajo çfarë është më e rëndësishmja, duhet që organizatat joqeveritare, që ndihmojnë në implementimin e Programit Y, mund t'ju ndihmojnë me zhvillimin e propozimit dhe mund t'ju ofrojnë burime që mund t'ju ndihmojnë me procesin (si faqet e internetit që ofrojnë disa opsione për fonde).

### 4. Gjetja e fondeve online

Ditët e sotme, gjetja e fondeve online është shumë e njohur dhe këtu mund të gjeni disa mënyra që mund t'ju duken interesante:

Publikoni në faqen e internetit të shkollës, ku njerëzit, organizatat, donatorët e interesuar mund të dhurojnë fonde drejtpërsëdrejti për shkollën. Mund të kërkonit nga zbatuesi i teknologjisë së informacionit që ta shtojë këtë faqe në web-in tuaj ku, përveç të tjerave, ju mund të prezantoni vizionin dhe idetë tuaja, në të cilat fondet mund të kontribuojnë e të ofroni informacionin e nevojshëm teknik për dhurim. Gjithashtu, ky është vendi ku ju mund të radhitni donatorët aktualë, si dhe ata të mëparshëm, dhe ku ju publikisht shfaqni mirënjohjen për ta.

Financimi nga turma e njerëzve (gjetja e fondeve përmes njerëzve) është praktika e gjetjes së fondeve përmes sigurimit të shumave të vogla të parave prej një numri të madh njerëzisht, kryesisht përmes internetit. Ju zgjidhni platformën online, publikoni idenë tuaj (përmes dokumenteve, zakonisht përmes videove apo infografika-ve). Tanimë, kjo metodë është shumë e njohur. Më shumë informacion mund të gjeni te [www.crowdfunding.com](http://www.crowdfunding.com)

## Shembuj të gjetjeve të suksesshme të fondeve

Ka shumë shembuj të gjetjeve të suksesshme të fondeve nga shkollat në Ballkan. Ju tashmë i dini disa prej tyre:

Missing examples...

## Këshilla

Më poshtë keni disa këshilla për gjetje të suksesshme të fondeve, këshilla që ju duhen kur dëshironi të siguronit të hollat që ju duhen, duke mbajtur marrëdhënie të mira me komunitetin e shkollës.

1. **Përfshini nxënësit/et, prindërit, mësimdhënësit/et, anëtarët/et e komunitetit në të gjitha fazat e gjetjes së fondeve; që nga përcaktimi i vizionit e deri tek implementimi i aktiviteteve.**
2. **Provoni të organizoni aktivitete motivuese dhe argëtuese, në të cilat njerëzit kanë dëshirë të shkojnë.**
3. **Qëndroni aktivë në ruajtjen e kontakteve me donatorët, por mos e teproni.**
4. **Mendoni edhe përtej kutisë – aktivitetet e zakonshme dhe tradicionale për gjetjen e fondeve janë shumë të mira, por edhe se çfarë mund të bëni ndryshe.**
5. **Përqendrohuni në qëllimin përfundimtar – të jeni të qartë se përse po kërkonti fonde.**
6. **Shprehuni personalisht – nxënësit/et mund të jenë gjetës të mrekullueshëm të fondeve, nëse ata/ato tregojnë historitë e tyre, përparësitë e tyre se për çfarë iu nevojiten paratë. Inkurajojini ata/ato që të flasin dhe të bëjnë pyetje:**

### Faqe interneti që mund t'ju ndihmojnë:

[www.easy-fundraising-ideas.com](http://www.easy-fundraising-ideas.com)

<https://blog.fundly.com/fundraising-ideas-for-schools-and-education/>

<http://schoolaid.co.nz/7-awesome-fundraising-ideas/>

<https://www.groundwork.org.uk/school-a-z>

<http://www.coolfundraisingideas.net/school-fund-raising-idea>

<https://www.opencolleges.edu.au/informed/other/school-fundraising-ideas/>

<https://www.youcaring.com/c/school-fundraising>